

20221231693

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

L I G J PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Neni 1

Në Ligjin e Bujqësisë dhe të Zhvillimit Rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 49/10, 53/11, 126/12, 15/13, 69/13, 106/13, 177/14, 25/ 15, 73/15, 83/15, 154/15, 11/16, 53/16, 120/16, 163/16, 74/17, 83/18, 27/19, 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 152/19, 244/19, 275/19 dhe 110/21) në nenin 61, pas paragrafit (3) shtohen tre paragrafë të rinj (4), (5) dhe (6), si vijojnë:

"(4) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse ekonomia bujqësore ka qenë shfrytëzues i mbështetjes financiare në bujqësi, pa ndërprerje, në tri vitet e mëparshme, realizimi i pagesave direkte për sipërfaqe, lëndë e kërkesës për mbështetje financiare, të cilat në pajtim me aktin e nenit 47 të këtij ligji nuk bëhen pagesa direkte shtesë, para se të konstatohet se shfrytëzuesi i plotëson kushtet për dhënien e pagesave direkte.

(5) Pagesa nga paragrafi (4) të këtij neni, ekonomisë bujqësore i paguhet në afat prej 90 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës, ndërsa pjesa e mbetur e përkrahjes financiare paguhet pas vendimit për miratimin e mbështetjes financiare në afatin nga paragrafi (2) i këtij neni.

(6) Nëse në procedurën për kontroll administrativ ose kontroll në terren konstatohet se ekonomia bujqësore, nuk i plotëson kushtet për dhënien e pagesave direkte, Agjencia do t'i kthejë mjetet e pranuar në pajtim me paragrafët (4) dhe (5) të këtij neni në procedurë të paraparë me Ligjin e Themelimit të Agjencisë së Mbështetjes Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural".

Neni 2

Në nenin 72, paragrafi (1) nënparagrafin 2) lidhëza "dhe" zëvendësohet me presje.

Në nënparagrafin 3), pika në fund të fjalisë zëvendësohet me lidhëzën "dhe".

Pas nënparagrafin 3), shtohet nënparagrafi i ri 4) i cili thotë:

"- investime në automjete komerciale për shitjen e drejtpërdrejtë të produkteve bujqësore dhe përpunimin e produkteve bujqësore".

Paragrafi (2) ndryshohet dhe thotë:

"Të drejtën e mbështetjes nga paragrafi (1) nënparagrafët 1) dhe 2) të këtij neni kanë shoqëritë tregtare dhe kooperativat që i plotësojnë kushtet për kryerjen e veprimtarisë në pajtim me ligjin, si dhe për mbështetjen nga paragrafi (1), nënparagrafi 4) të këtij neni kanë persona fizikë, të cilët janë të regjistruar në evidencat e operatorëve ushqimorë dhe objekteve për prodhimin dhe përpunimin e sasive të vogla të produkteve me origjinë shtazore dhe/ose joshtazore. Mbështetja nga paragrafi (1), nënparagrafi 3) të këtij neni mund të dedikohet për investime publike nga subjektet shtetërore, partneriteti publiko-privat ose njësitë e vetëqeverisjes lokale".

Neni 3

Në nenin 92, paragrafi (11) pas presjes së numrit "67" shtohen fjalët: "67-a,"

Neni 4

Në nenin 98-c në paragrafin (2), përqindja "50%" zëvendësohet me përqindjen "100%"

Neni 5

Në ligjin për plotësimin e Ligjit të Bujqësisë dhe të Zhvillimit Rural (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 110/21) në nenin 1, paragrafi (1) pas fjalëve: “Programi për mbështetje financiare në bujqësi për vitin 2021”, shtohen fjalët: "dhe Programi për mbështetjen financiare në bujqësi për vitin 2022", e pas fjalëve: "Programi për mbështetjen financiare të zhvillimit rural për vitin 2021" shtohen fjalët: "dhe Programi për mbështetjen financiare të zhvillimit rural për vitin 2022".

Në paragrafin (2) pas fjalëve: "Programi për mbështetje financiare në bujqësi për vitin 2021" shtohen fjalët: "dhe Programi për mbështetje financiare në bujqësi për vitin 2022", dhe pas fjalëve: "Programi për mbështetjen financiare të zhvillimit rural për vitin 2021", shtohen fjalët: “dhe Programi për mbështetjen financiare të zhvillimit rural për vitin 2022”.

Neni 6

Dispozitat e nenit 1 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari 2023.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.